



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura e V-të

Komisioni për Buxhet dhe Financa

Mbledhja nr. 27/15

Prishtinë, më 15.07.2015, ora 11:30

Ndërtesa e Kuvendit të Kosovës, salla C-203

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR BUXHET DHE FINANCA

Ne mbledhje morën pjesë: Naser Osmani, Jelena Bontić, Latif Gashi, Labinotë Demi-Murtezi, Besa Gaxherri, Ilir Deda, Bali Muharremaj, Fikrim Damka dhe Enver Hoti.

Munguan: Safete Hadergjona dhe Bardhyl Meta.

Deputetë pjesëmarrës nga komisionet tjera parlamentare: Jasmina Živković (Kryetare e Komisionit për të drejtat dhe interesat e komuniteteve dhe kthim) Çerim Bajrami (anëtar i komisionit për të drejtat dhe interesat e komuniteteve dhe kthim).

Pjesëmarrës të ftuar: Avdullah Hoti – Ministër i Financave, Agim Krasniqi, zv. ministër i financave.

Gjithashtu të pranishëm ishin edhe: Rejhane Zylfijaj dhe Ramadan Islami nga GIZ.

Nga stafi mbështetës i komisionit: Vilson Ukaj, Sabrije Iseini, Dashurije Canolli dhe Merita Zogjani (Praktikante).

Mbledhjen e kryesoi: Naser Osmani, Kryetari i Komisionit.

Rendi i ditës:

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Shqyrtimi i amendamenteve të Komisionit për të drejtat dhe interesat e komuniteteve dhe kthim;**
- 3. Miratimi i Raporti final me amendamente për Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.05/L-001 për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2015;**
- 4. Të ndryshme.**

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi ditës miratohet njëzëri

2. Shqyrtimi i amendamenteve të Komisionit për të drejtat dhe interesat e komuniteteve dhe kthim

Kryetari – njoftoi se kemi pranuar dy amendamente nga Komisioni për të drejtat dhe interesat e komuniteteve dhe kthim si komision funksional, dhe këto amendamente janë propozuar jashtë afatit të përcaktuar me Vendimin e Kuvendit për shmangien e Rregullores së Kuvendit, për shqyrtimin e rishikimit të buxhetit 2015, por për shkak të kolegjalitetit do ti trajtojmë këto amendamente. Më pas lexoi përmbajtjen e amendamenteve të propozuara. Për qendrën historike të Prizrenit dhe fshatin Hoqë e Madhe, kemi diskutuar edhe në takimin e grupit punues, ka qenë propozim i zëvendës-kryeartës së dytë të komisionit dhe le të arsyetojë.

Jelena Bontić - nuk është amendamenti im por i komisionit për të drejtat dhe interesat e komuniteteve dhe kthim. Në fakt ky amendament duhet të jetë i 120 deputetëve të Kosovës, sepse këto ligje i kemi miratuar në vitin 2012 dhe është dashur të ndahen mjetet financiare për zbatimin e tyre. Komisioni përkatës ka monitoruar zbatimin e këtyre lugjeve, dhe gjatë takimeve me përfaqësuesit e Komunës së Prizrenit dhe Rahovecit ka marrë informata dhe kërkesa që të ndahen mjetet buxhetore për funksionimin e këtyre këshillave. Unë mendojë që ne si komision duhet ti përkrahim këto amendamente.

Avdullah Hoti – njoftoi se kërkesa për këshillin në fashitim Hoqë e Madhe ka ardhur me kohë nga Komuna e Rahovecit, e kemi trajtuar me rishikim të buxhetit dhe e kemi zgjedh problemin duke ndarë një sasi të mjaftueshme të mjeteve për shpenzimet që janë të mjaftueshme për pjesën e mbetur të vitit. Për qendrën historike të Prizrenit nuk kemi pas kërkesë nga komuna e Prizrenit.

Jelena Bontić – këto këshilla janë funksionalizuar këtë vit, dhe nuk kanë mundur të parashtrojnë kërkesën me rishikimin e buxhetit. Komunitat nuk kanë qenë të obliguara që të paraqesin kërkesën sepse kjo është një është kërkesë ligjore dhe i kemi ligjet e miratuara për këtë.

Agim Krasniqi – ligji thotë se komunitat përkatëse duhet bërë propozimin për buxhet për këshillat përkatëse. Kur është bërë propozimi për buxhet, këto dy këshilla nuk kanë qenë të formuara dhe në ndërkohë janë themeluar. Për këshillin në fshatin Hoqë e Madhe, komuna e Rahovecit ka bërë kërkesën me shumat buxhetore për tërë vitin. Në Ministri të Financave e kemi trajtuar dhe kemi ndarë buxhet për këtë këshill që mbulon kohën prej prillit kur është funksionalizuar dhe deri në fund të vitit. Sa i përket rastit të qëndresës historike të Prizrenit nuk kemi pranuar ndonjë kërkesë nga Komuna. Amendamenti nuk është përgatitur si duhet as proceduralisht dhe teknikisht.

Jelena Bontić - duke pas parasysh se nuk ka kërkesë nga komuna, ne emër të komunës janë parashtuar amendamentet nga ana e komisionit për të drejtat dhe interesat e komuniteteve dhe kthim, që përfaqëson edhe komunitat.

Latif Gashi - ne po flasim për shumat buxhetore jo të mëdha që është dashur të jenë pjesë e buxhetit të komunitave përkatëse, por kërkesa ka ardhur me vonesë dhe tani nuk e kuptoj se si komisioni ka marrë të drejtën me propozue amendament për një kërkesë që nuk ka ardhur nga kuvendi komunal. Ju kisha lutur këtyre dy deputeteve me pas konsideratë se ne nuk jemi kundër kësaj por në mungesë të bazës ligjore e vonesave me procedura me mirëkuptim me e refuzue këtë amendament.

Avdullah Hoti - për Hoqën e Madhe është kryer, ndërsa për Qendrën historike të Prizrenit, propozoj që Komuna e Prizrenit ta sjell një kërkesë dhe e trajtojmë brenda qeverisë dhe për këtë vit gjejmë zgjidhje dhe do të trajtohet në formën e rregullt me buxhetin e vitit 2016.

Besa Gaxherri – amendamenti as në aspektin procedural dhe as ligjor nuk i plotëson kushtet për tu trajtuar. Për Hoqën e Madhe qenka e zgjidhur, ndërsa për Qendrën historike të Prizrenit, do të duhej zgjidhur përmes komunës, dhe mendojë që duhet të tërhiqni amendamentin se edhe ashtu nuk i plotëson kushtet.

Jelena Bontić - angazhimi ynë për këto dy ligje është ekskluzivisht që ligjet të zbatohen në teren. E kemi ditur se këto dy ligje kërkojnë mjete financiare, unë nuk jam kundër komisionit dhe ministrisë, por duhet të ekzistojë një bashkëpunim i mirë që për këto dy ligje dhe të gjitha ligjet tjera të miratuara nga Kuvendi të zbatohen.

Agim Krasniqi – edhe ne jemi për zbatimin e ligjeve të miratuara. Ne sqaruam se si ka rrjedhur çështja e kërkesës për fshatin Hoqë e Madhe dhe po ashtu sqaruam se nuk kemi pas kërkesë për qendrën historike të Prizrenit dhe jemi të gatshëm që brenda qeverisë të gjejmë një zgjidhje për ndarjen e mjeteve për pjesën e mbetur të vitit dhe në buxhetin 2016 të trajtomë sipas formës së rregullt. Ministria e Financave, mjetet si transfere që i ka nuk janë mjete të ministrisë, por janë pagesat që bëhen për veteranët e luftës dhe pjesa tjetër që transferohet në ministrinë e punës dhe mirëqenies sociale për pagesat për çështjet sociale.

Kryetari – ministri propozojë që të ndahen mjetet për qendrën historike të Prizrenit dhe nëse e përkrahim ky do të shkonte si amendament i komisionit tonë, ndërkaq komisioni për komunitet do të duhej të tërhiqte amendamentin, pasi që edhe ashtu nuk i plotëson kushtet ligjore.

Avdullah Hoti – ndarja e mjeteve për Hoqën e Madhe është e kryer në procesin e rishikimit buxhetor. Sa i përket Qendrës historike të Prizrenit dhe fshatin Zymë i Hasit, propozojmë që të marrim mjetet nga subvencionet nga Ministria e kthimit e komunitete për këtë pjesë të viti që ka mbetur në shumë prej 15,555 euro për secilin.

Jelena Bontić – sa herë që flitet për komunitet, qoftë për infrastrukturë apo shkolla apo financime tjera, apostrofohet tek ministria për komunitete dhe kthim, kur dihet se këto fusha janë përgjegjësi e ministrive tjera dhe mendojë që propozimi nuk është korrekt.

Kryetari - pse po reagoni në këtë mënyrë dhe konsideroni ministrinë vetëm për komunitetin serb. Ministri po thotë se këto mjete që u propozuan janë të mjaftueshme për me funksionue këtë vit dhe ku merren mjetet është problemi i qeverisë.

Avdullah Hoti – sa i përket çështjeve financiare brenda qeverisë, na leni neve këto përgjegjësi. Nëse ministria për komunitet dhe kthim ka projekte, ne obligohemi me ja kthye ato mjete që ia kemi marrë dhe nuk keni nevojë me u shqetësue, por e rëndësishme është me u plotësue kërkesa.

Jelena Bontić - nuk po shqetësohem, por realisht po flas edhe me argumente dhe jam shumë e qetë dhe qëndroj mbas fjalëve të mia dhe propozimi juaj nuk është korrekt.

Kryetari – amendament 2 i propozuar nga komisioni për të drejtat dhe interesat e komuniteteve dhe kthim është i ngjashëm me amendamentin e propozuar nga deputetja Duda Balje dhe ka të bëjë me ndarjen e mjeteve për tekstet mësimore për komunitetin boshnjak. Ne e kemi diskutuar këtë amendament dhe kemi thënë se janë ndarë mjete prej 5.5 milion euro për blerjen e teksteve shkollore në Ministrinë e Arsimit dhe këto mjete janë për të gjitha tekstet shkollore në tërë Kosovën.

Ćerim Bajrami – amendamenti ka të bëjë me ndarjen e mjeteve buxhetore për blerjen e librave në gjuhën boshnjake, duke filluar nga abetarja, dhe aktualisht nuk kemi asnjë fletore pune, dhe në shkollat e

mesme nuk kemi asnjë libër. Ministria e Arsimit na ka thënë se në buxhetin ekzistues nuk ka mjete për blerjen e librave. Ne kemi propozuar që nga mjetet të merren nga buxheti i Zyrës së Kryeministrit, respektivisht nga zyra për komunitete, kur dihet pjesë e buxhetit të kësaj zyre i takon edhe komunitetit boshnjak.

Kryetari - në bazë të ligjit, qeveria e ka për obligim me i nda mjete për nxënësit e shkollave fillore dhe një obligim i tillë nuk ekziston për nxënësit e shkollave të mesme. Prandaj në Ministrinë e Arsimit nuk ka mjete të ndara për tekstet mësimore për shollat e mesme që edhe po i kërkoni.

Agim Krasniqi - mbi bazën e ligjit për arsimin parauniversitar, Ministria e Arsimit, ka për obligim për te gjitha shkollat fillore, me iu sigurue libra prej klasës së parë deri ne të nëntën. Ndërsa për shkollat e mesme nuk ka obligim ligjor.

Ilir Deda - te gjithë duhet me tregu sensibilitet për arsim në gjuhen amtare. Nuk është në rregull, por fëmijët me tyre janë duke u asimiluar dhe nuk i keni vizituar. Duhet treguar sensibilitet më të madh për shkolla, kur dihet se dhjetë vite kemi kaluar nëpër këtë situatë dhe duhet ndarë mjetet prej 50,000 euro që kërkohen për këtë qëllim.

Latif Gashi - sa i përket amendamentit për blerjen e librave për komunitetin boshnjak unë nuk po shoh ndonjë zgjedhje për me e nda mjete prej atij fondi, kur këta zotëritë nuk din saktë numrin e fëmijëve. A keni bërë kërkesën në ministri dhe çfarë përgjigje keni marrë?

Ćerim Bajrami – Ministria e Arsimit është e obliguar me i sigurue librat dhe deri më tani nuk i ka siguruar, sepse është vështirë që për 100 libra të gjindet autori. Ne jemi të kuptueshëm dhe është lehtësira me i marrë prej Bosnje dhe ne këtë mund ta sigurojmë, dhe nëse nuk kalon ky amendament kemi me e prishur dhe asnjë votë nuk do të ketë.

Latif Gashi - ne jemi komision për buxhet e financa dhe këtu vie në shprehje më tepër ekspertiza se sa politika. Me mirësjellje ju kemi thirr me arsyetue amendamentin që e keni bërë jashtë çdo procedure dhe ju lutem të mos flisni me këtë tonë të zërit apo me gjuhën e shantazheve.

Besa Gaxherri – ne e kemi vullnetin politik dhe financiare për çdo komunitet në Kosovë. Po ju bëjë një pyetje konkrete: çfarë plan programi është qe te merrni librat prej Bosnje, sa janë kompatible me historinë dhe problematikat ne Kosovë, që është e njëjtë sikurse edhe me komunitetin turk. Por, po pajtohem se ministria jonë është përgjegjëse që nuk ka punuar bashkë me ju dhe që librat nuk janë shtypur këtu.

Kryetari – ndarja e 12,000 euro është çështje ligjore dhe mjetet janë në buxhetin e ministrisë së arsimit, për të cilën nuk duhet me diskutue me tutje. Çështja e 50,000 eurove nuk mbulohet ligjërisht dhe është kërkesë e komunitetit boshnjak që është në kompetencën e ministrisë së arsimit sa a mundet me i nda nga fondi i ministrisë prej 5.5 milion eurove. Propozojë që amendamenti të mos përkrahet nga Komisioni.

Kryetari konstatoi se me katër vota Kundër, një Për dhe një Abstenim, Komisioni nuk përkrahu Amendamentin 2 të Komisionit për të drejtat dhe interesat e komuniteteve dhe kthim.

Kryetari – sa i përket amendamentit 1, kryearti njoftoi kryetaren e Komisionit për të drejtat dhe interesat e komuniteteve dhe kthim për qëndrimet e anëtarëve të komisionit, për propozimin e ministrisë të financave për zgjidhjen e këtij problemi dhe për mos përmbushjen e kushteve teknike dhe ligjore të amendamentit.

Jasmina Živković – sa i përket amendamentit të parë sa për informata, Komisioni për të drejtat dhe interesat e komuniteteve dhe kthim, i ka monitoruar të dy këto ligje, që janë miratuar në prill të vitit 2012. Komisioni ka vizituar Rahovecin, po ashtu komisioni ka pas gjithashtu edhe një debat publike ku ministri i ambientit, ka qenë i ftuar dhe ka prezantuar zv. ministri, i cili ka thënë se nuk është i informuar për këtë problematikë. Këto ligje nuk janë vetëm për komunitetin serb por për të gjithë qytetarët e Kosovës. Ministria për komunitet dhe kthim nuk është e obliguar të ndajë mjete për këtë qëllim, pasi që kjo çështje është në kompetencë të Ministrisë së ambientit dhe Ministrisë së kulturës. Këto këshilla që janë të parapara me ligj, duhet të përfshihen në buxhetin dhe të kenë një rrjedhë buxhetore. Shumat janë minimale dhe duhet të ndarë mjetet që të funksionojnë në këtë vit.

Avdullah Hoti - i kemi tri kërkesa. Kërkesa për fshatin Hoqë e Madhe është e kryer dhe janë ndarë mjetet në procesin e rishikimit buxhetor. Sa i përket Qendrës historike të Prizrenit dhe për fshatin Zymë i Hasit, propozojmë që të marrim mjetet nga subvencionet nga Ministria e kthimit e komunitete për këtë pjesë të viti që ka mbetur në shumë prej 15,555 euro, për secilën. Në rast se Ministrisë për komunitete dhe kthim i nevojiten mjetet, ne ia kthejmë këto mjete që propozojmë ti merren tani. Ndërkaq në vitin 2016, i fusim në proces të rregullt buxhetor të financimit.

Jasmina Živković - siç thash se nuk duhet të jetë Ministria për komunitet dhe kthim që do të merren këto mjete dhe për çdo ligj që ka të bëjë me komunitete kërkohej mjete prej kësaj ministrie. Unë besoj që kanë obligim të tjerat ministri për financimin e këtyre këshillave deri në fund të vitit.

Avdullah Hoti – ne si qeveri po marrim obligim me i gjet mjetet për ti financuar këto kërkesa në bazë të shumave që propozova dhe është çështje e jona se si i sigurojmë mjetet. Për këtë vit propozova sa ku të merren mjetet, ndërsa për vitin e ardhshëm i gjejmë dikun tjetër.

Jasmina Živković – kjo duhet të menaxhohet bashkërisht, por që Ministria për planifikim hapësinor dhe Ministria për kulturë e kanë për obligim që të financojnë këto këshilla.

Agim Krasniqi – sqaroj se ministrinë që përmendi parafolësja, nuk kanë mjete të lira dhe ministri tregojë se ku janë mjetet më të lira që është Ministria për komunitete dhe kthim dhe nëse ka nevojë ne ja sigurojmë mjetet.

Besa Gaxherri – kjo është e papranueshme por nuk e di pse duhet me mendue ku duhet me i marrë mjetet, kur ministri zotohet se do ti sigurojë mjetet në rast se ato mungojnë. Ne e kemi një buxhet të konsoliduar dhe nuk është e rëndësishme se ku merren mjete, por e rëndësishme është me u realizue kërkesat, për çfarë edhe ka gatishmëri që të gjindet zgjidhja.

Kryetari konstatoi se me pesë vota Kundër, një Për dhe asnjë Abstenim, Komisioni nuk përkrahu Amendamentin 1 të Komisionit për të drejtat dhe interesat e komuniteteve dhe kthim.

Kryetari – theksoi se kemi kërkesën e ripërsëritur për investime kapitale për Kuvendin e Kosovës, që ka të bëjë me nënprogramin-Administrata e Kuvendit, përkatësisht për projektin “Modernizimi dhe pajisa me teknologji digjitale të sallave konferenciale dhe të sallës plenare”, që shuma prej 3,040 euro, të ndryshohet në shumën 103,040 euro, pra të shtohen edhe 100,000 euro

Besa Gaxherri – ne kemi mungesë për gjithçka. Nuk është në rregull që policia të na kontrollojë nëpër çanta dhe mos të kemi mjetet përkatës për këtë punë dhe kjo është e pakuptimtë. Por edhe stafi i komisionit të buxhetit nuk mundet me u pague njëjtë si stafet e komisioneve tjera që mbajnë një mbledhje në muaj dhe duhet diskutuar dhe rregulluar këto gjëra.

Kryetari konstatoi se Komisioni njëzëri miratojë propozimin që në buxhetin e Kuvendit të Kosovës, në Nënprogrami- Administrata e Kuvendit, në kategorinë shpenzime kapitale, projekti me kod 12979, “Modernizimi dhe pajisa me teknologji digjitale të sallave konferenciale dhe të sallës plenare”, shuma prej 3,040€, të ndryshohen në shumën 103,040€. Mjetet prej 100,000 zvogëlohen në nënprogramin- Shpenzimet e paparashikuara.

3. Miratimi i Raporti final me amendamente për Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.05/L-001 për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2015

Kryetari – njoftoi anëtarët se Komisionet tjera të përherëshme e kanë shqyrtuar Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.05/L-001 për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2015 dhe amendamentet e komisionit funksional dhe nuk kanë bërë ndonjë vërejtje apo propozim dhe si i tillë raporti final me amendamente do të procedohet për shqyrtim dhe miratim në lexim të dytë në seancë plenare.

4. Të ndryshme

Kryetari - njoftoi anëtarët se Komisionet tjera të përherëshme e kanë shqyrtuar Projektligjin për faljen e borxheve publike dhe amendamentet e komisionit funksional dhe nuk kanë bërë ndonjë vërejtje apo propozim dhe si i tillë raporti final me amendamente është i gatshëm dhe në emër të Komisionit do të kërkojë që të futet si pikë plotësuese në seancën e nesërm për shqyrtim dhe miratim në lexim të dytë në seancë plenare.

Mbledhja përfundoi në ora 13:44

Përgatitur nga:

Njësia për mbështetjen e Komisionit

Naser Osmani